

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Nga Sonila Meço - 'Në emër të popullit të Kosovës', prokura e një kurthi
ADRESA	https://www.syri.net/op-ed/917225/ne-emer-te-popullit-te-kosoves-prokura-e-nje-kurthi/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 19:56:14 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 19:47:28 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	0f91a6ceb65bec749d2e0825644efdce9a545315bec0a9519504e981168419a1
TEKSTI	b61a1739f4223e3801a72472624b14d6858634acab965c44a6f4fd7edeeb5b4f
PAMJA	f508e6395513cc90296bfd3fd24a8e7cbf2bb5e12df90a65638d67f324bcb2c2

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	43931b1c955890fb12df0d5c28a60846c523756e8541bb0c8dfc988a6ffb713e
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	f72115bb0c326093347f412235a8c378aab409f85fb276171d0e9653b9a6bcbd
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/43931b1c955890fb12df0d5c28a60846c523756e8541bb0c8dfc988a6ffb713e>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



SONILA MEÇO
'Në emër të popullit të Kosovës', prokura e një kurthi



ÇIM PEKA
Tradhtia që s'e panë tu ardhë

LAJMI I FUNDIT

LIVE/ Protesta e 109-të, marshimi në Tiranë, protestuesit: Rama jepe dorëheqjen!



më të lexuarat



Vera e protestave në Pakistan – dhe bota nuk e vuri re



Shtrengimi i gazit në Evropë: Çfarë lloj dimri na pret?



A mund t'i mbijetojë tregu i naftës një luftë të përjetshme me Iranin?



Tradhtia që s'e panë tu ardhë



Mashtrimi me PISA 2025 dhe dekada e dështimit të arsimit shqiptar



'Në emër të popullit të Kosovës', prokura e një kurthi



'Në emër të popullit të Kosovës', prokura e një kurthi



Nga Sonila Meço - 21:47, 16/09/2026

Për Kosovën lajmi se Gjykata Speciale në Hagë i shpalli katër ish-krerët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës Thaçin, Krasniqin, Veselin e Selimin fajtorë për katër akuza për krime lufte, ndërsa i liroi nga akuzat për krime kundër njerëzimit, duke i dënuar së bashku me 81 vite burgim (thujse një shekull) është i rëndë. Por ndërsa janë çliruar nga akuzat për krime kundër njerëzimit, asnjë verdikt gjykatë nuk ka mundur të verë nën akuzë e pale të dënojë një popull dhe arsyen përse luftoi.

Është shumë e freskët dhimbja, shumë e rëndë pesha e emrave dhe shumë e madhe historia që ata përfaqësojnë, që dikush nga jashtë t'u shpjegojë kosovarëve se si duhet ta ndiejnë këtë vendim.

Prandaj, së pari, respekt për dhimbjen.

Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi nuk janë për Kosovën thjesht katër të pandehur. Janë njerëz të lidhur pazgjidhshmërisht me një kohë kur shqiptarët e Kosovës nuk diskutonin për jurisprudence ndërkombëtare, por për mbijetesë, gra të përdhunura, terrorizëm, vrasje masive, shtëpi të djegura, familje të dëbuara, genocid dhe liri.

Dhomat e Specializuara e shpallën Thaçin, Krasniqin, Veselin e Selimin fajtorë për krime lufte: ndalim arbitrar, trajtim mizor, torturë dhe vrasje. Por i shpallën të pafajshëm për krime kundër njerëzimit, sepse Prokuroria nuk provoi përtej dyshimit të arsyeshëm ekzistencën e një sulmi të gjerë ose sistematik kundër popullsisë civile. Gjykata tha gjithashtu se disa incidente konkrete të pretenduara si krime lufte nuk u provuan. Vendimi është i shkallës së parë. Apeli vijon në shkallë të tjerë.

Ky qe lajmi. Por e gjithë historia buron nga ca cene që e dobësojnë vendimin juridikisht, politikisht e moralisht.

Dhomat e Specializuara të Kosovës në Gjykatën e Hagës e kanë cenin që në certifikatën e lindjes.

Ato "erdhën në jetë" pas ndryshimeve kushtetuese të vitit 2015. Këshilli i Europës pohoi se këto ndryshime u miratuan "under pressure from the International Community"(nën presionin e Komunitetit Ndërkombëtar). Juridiksioni i tyre u lidh posaçërisht me pretendimet e raportit të Dick Marty-t dhe të tjera për krime të lidhura me UÇK-në në periudhën 1998–2000. Të gjitha të rrëzuara tashmë. Një kurth me shumë autorë.

Cenet vijojnë më tej. Quhen gjykatë e Kosovës, por ndodhen jashtë saj.

Zbatojnë ligjin e Kosovës, por përbëhen nga ndërkombëtarë.

U krijuan me votën e Kuvendit të Kosovës, por pas një presioni ndërkombëtar të dokumentuar.

Mandati i tyre u ndërtua mu bash prej pretendimeve për krime të lidhura me një krah të vetëm të luftës.

Seanca të mbyllura dhe një gjykatë larg vendit ku ndodhën ngjarjet. Dëshmi jo transparente. Madje vetë akuzat nuk kanë vendngjarje.

Asimetria ulëret edhe më tej si cen i dukshëm, sepse kúti matës nuk është i njëjtë për të gjitha palët e përfshira në luftë.

Në tokën e Kosovës nuk pati dy palë që u zgjuan një mëngjes dhe vendosën të përlesheshin.

Një popull i tërë nën represion kundër një aparati shtetëror serb që ushtroi dhunë masive, përdhunime, dëbime, genocid dhe vrasje. E kjo batërdi solli një luftë çlirimtare që lindi në atë realitet.

Këto janë fakte, që nuk mund ta sterilizojnë asesi kontekstin historik gjersa viktima dhe agresori të barabiten si dy palë të një konflikti laboratorik.

Nëse një shqiptar ka torturuar apo vrarë një të burgosur, le të mbajë përgjegjësi. Pa "por".

Por po aq pa "por", përgjegjësia individuale nuk mund të shndërrohet, me kalimin e viteve, në një ekuivalencë morale mes projektit të represionit të egër dhe rezistencës historike ndaj tij.

Por ceni i ceneve është tjetër. Drejtësia mund të gjykojë individë. Mund të peshojë prova, të përcaktojë përgjegjësi, të dënojë krime. Dhe askush që ka luftuar për liri nuk fiton, vetëm për këtë arsye, imunitet për një krim të provuar.

Por "në emër të popullit të Kosovës" është një paradoks që dhemb në asht: një gjykatë e vendosur në Hagë, me gjyqtarë ndërkombëtarë, e krijuar për një juridiksion jashtëzakonisht të posaçëm, dënon katër prej figurave më të rëndësishme të luftës së Kosovës me frazën "në emër të vetë popullit të Kosovës." Çmenduri.

Cen pas ceni, mbërrimë tek një goxha problematik. A funksionon drejtësia penale ndërkombëtare në një vakum gjeopolitik? Sigurisht që jo. Gjykatat ndërkombëtare krijohen nga arkitektura politike, financohen prej saj, varen nga bashkëpunimi i shteteve dhe funksionojnë në një sistem ku fuqitë e mëdha kanë kapacitete shumë të ndryshme për t'iu nënshtruar juridiksionit.

A ishte ky gjyq i ndikuar nga gjeopolitika më shumë se nga vullneti për drejtësi? Po ja psh. aktakuza ishte depozituar nga Prokuroria më 24 prill 2020, por Prokuroria e bëri publike ekzistencën e saj më 24 qershor 2020, vetëm tri ditë përpara takimit Thaçi–Vuçiç të planifikuar në Shtëpinë e Bardhë më 27 qershor.

Kjo kronologji është fakt.

Madje vetë Prokuroria shpjegoi publikimin e pazakontë të aktakuzës ende të pakonfirmuar duke pretenduar se Thaçi dhe Veseli po përpiqeshin të pengonin ose minonin funksionimin e Gjykatës. Ky ishte argumenti i Prokurorisë, jo një konstatim i vendimit të sotëm.

Pse u bë publike një aktakuzë ende e pakonfirmuar pikërisht në atë moment diplomatik?

Pra ka një mister politik të ligjshëm për kohën.

Procesi zgjati 6 vjet, por me shtyrje që ndërldheshin në kohë me zhvillime gjeopolitike rajonale e ndërkombëtare.

Historia veç me tri shkronja



Nga çfarë kanë frikë ekspertët e 'superinteligjencës' së IA?

Ajo që dallohet përtej emocionit e zhgënjimit të çastit është se drejtësia ndërkombëtare prodhon perceptimin e universalitetit të normës, ndërsa fuqia ndërkombëtare prodhon selektivitetin e zbatimit të saj.

Ky cen bën që një udhëheqës i një shteti të vogël, që nuk ka konsoliduar ende infrastrukturën diplomatike, lobuese, atë të kujtesës, dokumentimit, historiografisë së jetë shumë më i ekspozuar ndaj mekanizmave ndërkombëtarë sesa drejtuesi i një fuqie ushtarake, bërthamore ose diplomatikisht të pazëvendësueshme.

Pa llogaritur këtu cenet e historisë, shekullore a më rishtarë.

Por ja që kështu funksionon kjo botë, ndaj së cilës shqiptarët nuk kanë luksin mos nxënë mësim.

Thaçi është produkt i të njëjtit rend perëndimor që sot e gjykon.

UÇK-ja fitoi terrenin politik dhe Kosova fitoi mundësinë historike të shtetësisë në një arkitekturë sigurie të dominuar nga SHBA dhe NATO.

Thaçi më pas u bë partner i Perëndimit.

President.

Negociator.

Njeri i tavolinave diplomatike.

Dhe mandej një institucion i krijuar nën presion të fortë ndërkombëtar e futi në paraburgim dhe sot e dënoi në shkallë të parë me 25 vjet.

Që do të thotë se rendi që prodhon një elitë politike nuk garanton imunitetin e saj të përhershëm.

Që do të thotë se aleanca politike nuk krijon imunitet penal.

Ky është mësim i madh.

Sepse janë njëkohësisht të vërteta të gjitha:

Se Thaçi e të tjerët në Hagë kanë qenë figura themelore të luftës çlirimtare të Kosovës.

Se Gjykata nuk ka gjykuar legjitimitetin e luftës së UÇK-së, por përgjegjësinë penale individuale.

Se Prokuroria nuk arriti të provojë krimet kundër njerëzimit.

Se paneli pretendon se provoi krime të tjera lufte përtej dyshimit të arsyeshëm, megjithëse nuk duhej të qe ky juridiksioni i tij, por i gjykatave në Kosovë.

Se mbrojtja mund ta sfidojë këtë në apel dhe të katërt të dalin të pafajshëm.

Se sistemi ndërkombëtar brenda të cilit zhvillohet ky proces nuk është politikisht neutral në kuptimin gjeopolitik të fjalës, përkundrazi.

Por ja që konteksti, ekuilibrat mund të ndryshojnë kuptimin politik të një gjyqi pa qenë shkaku juridik i tij.

Megjithëse shkaku juridik ra me rënien e arsyes së ngritjes së vetë Dhomave Speciale, raporti famëkeq i Dick Marty-t e ca broçkulla të ngjashme.

Por drejtësia ndërkombëtare, e krijuar për të qenë mbi politikën, dukshëm varet nga një rend ndërkombëtar ku ekuilibrat gjeopolitikë lëvizin gjithnjë më shpejt e më shpesh. Madje me dënimin e sotëm, Gjykata provoi se drejtësia e saj është shumë më e vogël sesa pushteti i saj për të dënuar. A kanë luksin shqiptarët të konsumohen në beteja mes vëdi, me shtete të bëra copë prej pushtetesh të pangjinjur?

Një aktgjykim ka dy jetë. Njërin në jurisprudencë dhe tjetrën në politikë. Në të parën mund të dënohen katër individë. Megjithëse e drejta e apelit në shkallë të tjera qendron aty. Në të dytën, ky vendim mund të citohet, përkthehet, përdoret dhe keqpërdoret për dekada.

Kosova e Shqipëria këtë s'duhet ta lejojnë.

Kosova vërtetë delegoi juridiksionin mbi një pjesë të historisë së vet, por zbuloi se bashkë me juridiksionin kishte deleguar edhe formulën e shpalljes së verdiktit në Hagë: "në emër të popullit të Kosovës".

Ndoshta nuk ka qenë ky gabimi më i madh i shqiptarëve, por kujdesi i munguar për kujtesën historike dhe konsumimi në beteja për pushtet, që na lëshuan krejt në besimin naiv se e vërteta jonë historike ishte aq e evidente, sa nuk kishte nevojë për dokumente, avokatë, arkiva shtetërore, institute studimore, universitete e

kërkime shkencore, diplomaci dhe memorie shtetërore.

Se çfarë ka bërë Serbia prej dekadash për ta relativizuar e interpretuar historinë e dimë. Se si janë organizuar aleatët e saj për të ndërtuar balancë mes një lëvizjeje për çlirim dhe një makine genocidiale terrori...edhe ky nuk është sekret.

Respekti për Kosovën meriton të mos i kërkojmë historisë të thotë atë që nuk ka thënë gjykata dhe gjykatës të vendosë për atë që i takon historisë.

Shqiptarët, pas kaq shumë shekujsh duke ua lënë të tjerëve procesverbalin e historisë së tyre, duhet të kenë kuptuar më në fund se liria fitohet me luftë, por ruhet me shtet të fortë. Kur nuk e shkruan ti historinë tënde, gjithmonë gjendet dikush që ta noterizon në Hagë.

© SYRI.net

Lexo edhe

- » Tradhtia që s'e panë tu ardhë
- » Gjuha si brushë dhe ironia si armë e Edi Ramës
- » Shtrëngimi i gazit në Evropë: Çfarë lloj dimri na pret?

Komentet

Shto koment

Emri

Shkruani komentin tuaj

Posto


TË NGJASHME



Nga çfarë kanë frikë ekspertët e 'superinteligjencës' së IA?



Vera e protestave në Pakistan – dhe bota nuk e vuri re



Historia veç me tri shkronja



Mashtrimi me PISA 2025 dhe dekada e dështimit të arsimit shqiptar



A mund t'i mbijetojë tregu i naftës një lufte të përjetshme me Iranin?



Fashizmi nuk duhet kërkuar tek revolta e protestuesve por në Kuvend!



Dialog me mbesën

LAJME POLITIKE KRONIKE EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË/STIL TRASHËGIMI MIEDIS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojme të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Staf i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.